





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Prishtinë, __/06/2020

Në mbështetje të nenit 8, 9, 10, 11, dhe 15 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr.7/01 Mars 2019), bazuar në nenin 8 dhe shtojcën 15 të Rregullores (QRK) Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ligjin Nr. 07/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Planin e Punës të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për vitin 2020, Shkresën nr. 106 të dt. 23/04/2020 për miratimin e Thirrjes për propozime në kuadër të PZHR 2020 si dhe Vendimin Nr. 108 të dt. 27.04.2020 për aprovimin e Udhëzuesit për Aplikantë dhe gjitha shtojcat e tij nga Programi për Zhvillim Rajonal 2020 lidhet kjo:

MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT
"Ndërtimi i depos për ruajtjen e patates në Pestovë"

Palët Nënshkruese

1. Ministria e Zhvillimit Rajonal e përfaqësuar nga Ministri i MZHR-së (në tekstin e mëtejme MZHR),
- dhe,
2. Komuna e Vushtrrisë e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, (në tekstin e mëtejme Komuna),

Neni 1 **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është bashkëfinancimi i projektit “Ndërtimi i depos për ruajtjen e patates në Pestovë”, si dhe përcaktimi i obligimeve të MZHR -së dhe Komunës së Vushtrrisë, për realizimin e këtij projekti.

Neni 2 **Vlera e projektit dhe mënyra e bashkëfinancimit**

1. Projekti “Ndërtimi i depos për ruajtjen e patates në Pestovë” ka vlerën para llogaritave prej 200,000.00 €.
2. MZHR nga buxheti i saj vjetor i vitit 2020, financon këtë projekt në shumën prej 60,000.00 €.
3. Komuna e Vushtrrisë nga buxheti i saj vjetor i vitit 2020, financon këtë projekt në shumën prej 70,000.00 €.
4. Pjesa tjetër e projektit në vlerën prej 70,000.00 € do të realizohet nga komuna në një fazë tjetër.

Neni 3 **Obligimet e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal**

1. MZHR -ja i zotëron mjetet për projektin nga neni 2 paragrafi 2 i kësaj Marrëveshje dhe një kopje e dërgon në Komunë.
2. Pagesat për projektin “Ndërtimi i depos për ruajtjen e patates në Pestovë” nga MZHR, do të bëhen në bazë të realizimit të punimeve/furnizimeve sipas kushteve të kontratës, në rastin e bashkëfinancimit të projektit pagesat e para behen nga mjetet e zotëruara të buxhetit të MZHR-së .
3. MZHR cakton një zyrtar monitorues lidhur me këtë projekt, i cili në rast se vëren parregullsi apo defekte gjatë realizimit të kontratës njofton menaxhmentin.

Neni 4 **Obligimet e Komunës**

1. Komuna është e obliguar që pas pranimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit të nënshkruar dhe të protokolluar të hartoj projektin zbatues si dhe të siguroj tërë dokumentacionin e nevojshëm që projekti nuk do të ketë pengesa në realizim.

2. Komuna obligohet të siguroj deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës së paralogaritur të projektit, dhe një kopje ta dërgoj në MZHR.

3. Komuna obligohet që projektin ta zhvilloi në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 e Prokurimit Publik të Kosovës, ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068, Ligjin Nr. 05/L-092 dhe Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, si dhe aktet nënligjore.

4. Komuna është bartëse e të gjitha procedurave të prokurimit sipas ligjit në fuqi. Procedurat e prokurimit, komuna duhet t'i filloj brenda 30 dite kalendarike pas nënshkrimit MiM në të kundërtën MZHR në mënyrë të një anshme mund të ndërpres marrëveshjen.

5. Komuna obligohet që pas nënshkrimit të kontratës me Operatorin Ekonomik të sjellë një kopje të kontratës identike me origjinalin në MZHR së bashku me informatat për biznesin me qëllim të sigurimit të nxjerrjes së urdhër blerjes (numrin e biznesit dhe numri i llogarisë bankare).

6. Komuna cakton projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për realizimin e projektit si dhe bën inspektimin final të punimeve/pranimin teknik.

7. Projekt menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasitë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagimin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.

8. Komuna obligohet që të njoftoj MZHR-në për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projektit, ndërsa për punime shtesë duhet të merret aprovim nga MZHR (për pjesën e financuar nga MZHR).

9. Komuna duhet të vendos tabelën informuese (Panon) standarde me shënimet për projektin, investitorët dhe operatorin ekonomik në vend punishte.

10. Komuna duhet të ndërmerr të gjitha masat që projekti të përfundoj gjatë vitit buxhetor 2020. Pas këtij afati të gjitha obligimet kalojnë në përgjegjësi të Komunës.

11. Komuna është e obliguar të njoftoj MZHR -në për rrjedhat e realizimit të projektit sipas dinamikës së punimeve deri në përfundim të projektit.

12. Komuna obligohet që pas përfundimit të projektit, obligimeve kontraktuale të dërgoj në MZHR dokumentacionin përkatës me të cilin dëshmohet përmbyllja e projektit.

Neni 5

Dokumentacioni i nevojshëm për pagesë nga Komuna

1. Komuna obligohet që për t'i realizuar pagesat për punët/furnizimet e kryera deri në shumën e financimit nga ana e MZHR -së, të kompletoj dokumentacionin si në vijim:

- 1.1 Kopjen e Kontratës të nënshkruar së bashku me Kushtet e përgjithshme, të veçanta dhe ofertën financiare identike me origjinalin e vërtetuar nga menaxheri i prokurimit të komunës;
- 1.2 Kopjen e deklaratës të disponueshmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës së parallogaritur të projektit;
- 1.3 Vendimi për caktimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionin e pranimi nga ana e Komunës;
- 1.4 Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionit të pranimi mbi punët/furnizimet e kryera dhe të aprovuara (situacionet);
- 1.5 Faturën origjinale nga operatori ekonomik dhe situacionin e aprovuar deri në shumën e financuar nga MZHR;
- 1.6 Sigurimin e ekzekutimit, garanacionin e kualitetit me pranim teknik sipas kushteve të kontratës;
- 1.7 Kopjen e certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik (nëse nuk është i regjistruar në SMIFK-Departamenti i Thesarit-Ministria e Financave).

Neni 6 **Pronësia e projektit**

1. Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik, ky investim (projekt) nga kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit do kalojë në pronësi të Komunës.
2. Ky investim regjistrohet në pronësi të komunës në mënyrë elektronike dhe fizike, në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

Neni 7 **Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Mirëkuptimit**

1. Me pëlqimin paraprak të Ministrit të MZHR -së, dhe Kryetarit të Komunës marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet.
2. MZHR mbanë të drejtën e ndërprerjes së Marrëveshjes në rast se konstaton se Komuna nuk i përmbush obligimet e veta të dala nga kjo Marrëveshje.

Neni 8 **Zgjidhja e mosmarrëveshjes**

Palët zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshje.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga Ministri i MZHR -së dhe Kryetari i Komunës.

Marrëveshja e Mirëkuptimit është nënshkruar në dy (2) kopje origjinale, nga një kopje për secilën palë nënshkruese.

Ivan Millojeviq
Ministër i MZHR -së



Xhafer Tahiri
Kryetari i Komunës së Vushtrisë

